

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Lufta kundër korrupsionit mbetet një sfidë madhore dhe njëkohësisht një prioritet strategjik për Shqipërinë në rrugën e saj drejt integritetit evropian. Ajo përbën një shtyllë themelore për përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky prioritet reflektohet qartë edhe në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, i cili është pjesë e politikës shtetërore dhe shënon piketën hapëse të grupkapitullit të parë “Themeloret”, të miratuar me Vendimin nr. 736, datë 13.12.2023 të Këshillit të Ministrave.

Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me *acquis* dhe me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e antikorrupsionit synon jo vetëm uljen e kompleksitetit normativ, por edhe rritjen e efektivitetit të tij. Ky qëllim realizohet nëpërmjet ndërmarrjes së masave të qëndrueshme ligjore, të cilat kontribuojnë në reduktimin sistematik të korrupsionit. Në këtë drejtim, forcimi i mekanizmave të sinjalizimit të shkeljeve dhe garantimi i mbrojtjes së sinjalizuesve përbëjnë një komponent thelbësor të përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e transparencës, forcimin e integritetit institucional dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrës. Hartimi i projektligjit synon të përmirësojë dhe të përafrojë më tej kuadrin ligjor shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, në veçanti me kërkesat e Direktivës (BE) 2019/1937 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të së drejtës së Bashkimit.

Projektligji i ri sjell një qasje të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse në trajtimin e sinjalizimit, duke adresuar mangësitë e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues. Ai mbështetet në analizën e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK), në krahasimin e kuadrit ligjor ekzistues me praktikën më të mira ndërkombëtare, si edhe në rekomandimet e Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (RAI). Qëllimi i projektligjit është garantimi i standardeve më të larta të mbrojtjes së sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat, si dhe ngritja e mekanizmave më efikasë për raportimin, trajtimin dhe ndjekjen e shkeljeve.

Parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit përbën një detyrim që rrjedh nga angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, të sanksionuara në instrumente si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit dhe Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit. Njëkohësisht, në mbështetje të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026, të miratuara me Vendimin nr. 859, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave, përcaktohen qartësisht drejtimit kryesore të politikave qeveritare dhe objektivat përkatëse në këtë fushë.

Në veçanti, objektivi 1.6 i Strategjisë parashikon forcimin e kornizës së sinjalizimit të shkeljeve si një instrument i rëndësishëm për zbulimin e hershëm të korrupsionit, duke mbrojtur punonjësit që shfaqin integritet të lartë dhe duke siguruar një mekanizëm shtesë kontrolli mbi veprimtarinë publike dhe private. Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor aktual bëhet i domosdoshëm, me qëllim sigurimin e shfrytëzimit sa më efektiv të këtij mekanizmi në identifikimin, trajtimin dhe ndjekjen e shkeljeve të mundshme të ligjit.

Ky projektligj synon krijimin e një kuadri të qartë dhe funksional ligjor për mbrojtjen e sinjalizuesve, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, të cilët raportojnë shkelje të mundshme të ligjit. Objektivi kryesor është ngritja e mekanizmave të besueshëm për sinjalizimin, shqyrtimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe vendosja e detyrimit për institucionet publike dhe subjektet private që të zbatojnë procedurat dhe standardet e përcaktuara për këtë proces.

Qëllimi i kësaj nisme legislative është parandalimi dhe luftimi i veprimeve të paligjshme në administratën publike dhe në aktivitetin privat, duke promovuar sinjalizimin si një instrument thelbësor për forcimin e integritetit institucional dhe sundimit të ligjit.

Njëkohësisht, projektligji harmonizohet me përpjekjet për modernizimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor kombëtar, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe praktikën e Bashkimit Evropian në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Projektligji përcakton qartë fushën e veprimit, në përputhje me parashikimet e Direktivës (BE) 2019/1937 dhe, në rastet kur aktet sektoriale të Bashkimit Evropian parashikojnë rregulla të posaçme për raportimin e shkeljeve, parashikon që të zbatohen rregullat e atyre akteve sektoriale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje të plotë me Programin e Qeverisë, Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2026, të miratuara me Vendimin nr. 859, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave.

Njëkohësisht, ndryshimet e propozuara burojnë drejtpërdrejt nga angazhimet e përcaktuara në Vendimin nr. 736, datë 19.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, dhe adresojnë gjetjet e evidentuara në Raportin e Screening për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, ku nënvizohet se kuadri ligjor i Shqipërisë në fushën e luftës kundër korrupsionit mbetet vetëm pjesërisht i harmonizuar me *acquis* dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh se Shqipëria ndodhet në një fazë vendimtare të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, përmbushja e detyrimeve që lidhen me forcimin e kuadrit antikorrupsion është bërë një prioritet qendror. Ndër këto detyrime, Komisioni Evropian ka

theksuar nevojën për miratimin e një kuadri të plotë ligjor që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si pjesë e paketës së reformave të kërkuara në procesin e anëtarësimit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Personi që zbulon ose raporton shkelje të kuadrit ligjor në një autoritet publik ose në sektorin privat shpesh përballet me mosbesim, kundërshtime, hakmarrje apo masa që kufizojnë të drejtat dhe mundësitë e tij për karrierë. Hezitimi për të raportuar shkeljet lidhet me një sërë faktorësh, që variojnë nga frika nga pasojat e mundshme, deri te mungesa e besimit se raportimi do të sjellë ndryshim. Thyerja e heshtjes është veçanërisht e vështirë, pasi shpesh nënkupton rrezikimin e reputacionit, prishjen e marrëdhënieve profesionale, humbjen e mbështetjes nga kolegët, cenimin e pozitës në punë apo edhe pasoja financiare për sinjalizuesin.

Për këto arsye, sinjalizuesi ka nevojë për mbrojtje dhe mbështetje të plotë për t'u përballur me çdo akt hakmarrës që mund të rrjedhë nga raportimi i shkeljeve të kuadrit ligjor, pavarësisht nëse ai ndodhet aktualisht në marrëdhënie pune, është në fazë rekrutimi apo kontraktimi, ose marrëdhënia e punës ka përfunduar. Projektligji, duke synuar forcimin e mbrojtjes së sinjalizuesve, zgjeron gamën e mbrojtjes edhe për personat e lidhur me sinjalizuesin, për ndihmësit dhe çdo individ tjetër që mbështet procesin e sinjalizimit, si dhe për personat juridikë me të cilët sinjalizuesi ka marrëdhënie pune ose biznesi.

Ligji nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, i ndryshuar, pavarësisht se ka vendosur disa rregulla për inkurajimin e individëve në denoncimin e korrupsionit, nuk ka siguruar një mbrojtje efektive dhe nuk është zbatuar në praktikë me nivelin e pritshëm të efikasitetit. Në këtë kuadër, projektligji i ri parashikon ngritjen e tre mekanizmave të sinjalizimit:

- **Sinjalizimi i brendshëm**, i kryer përmes njësive përgjegjëse të ngritura në autoritetet publike ose subjektet private, brenda mjedisit të punës ku individ i ka aktualisht një marrëdhënie pune;
- **Sinjalizimi i jashtëm**, i realizuar përmes autoritetit kompetent, ILDKPKI, jashtë strukturës së autoritetit publik ose subjektit privat ku është konstatuar shkelja;
- **Sinjalizimi publik**, që konsiston në bërjen publike të informacionit mbi një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor nga sinjalizuesi.

Një risi e rëndësishme e projektligjit është se, ndryshe nga kuadri ligjor aktual, sinjalizuesi që bën publik sinjalizimin gëzon të drejtën e mbrojtjes si subjekt i këtij ligji, me kusht që të plotësojë disa kriteret specifike. Këto përfshijnë: përpjekjen paraprake për të adresuar çështjen pranë njësisë përgjegjëse ose te ILDKPKI; ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme për të besuar se shkelja paraqet rrezik të menjëhershëm ose serioz për dëme të pakthyeshme në shëndetin publik, sigurinë, mjedisin ose interesin publik; ose rrethana që kufizojnë adresimin efektiv të shkeljes, si rreziku për fshehjen ose shkatërrimin e provave, apo situatat kur autoriteti kompetent mund të jetë bashkëpunëtor me të sinjalizuarin ose vetë i përfshirë në shkelje.

Objekti i sinjalizimit përcakton rregulla të qarta për mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat, për sinjalizimin e shkeljeve të mundshme të kuadrit ligjor, mekanizmat për raportimin dhe shqyrtimin e tyre, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private në lidhje me këtë proces. Këto parashikime shkojnë përtej korrupsionit, duke zgjeruar në mënyrë të ndjeshme fushën e zbatimit të ligjit.

Sinjalizues është çdo person fizik që, në një kontekst pune, sinjalizon ose bën publik informacion mbi një shkelje të mundshme. Në këtë kuptim, sinjalizues konsiderohet çdo individ që raporton ose publikon informacion mbi një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor dhe që ka statusin e punonjësit, punëkërkuarit, ish-punonjësit ose praktikantit, pavarësisht natyrës së marrëdhënies së punës, kohëzgjatjes së saj apo faktit nëse është i paguar apo jo. Sinjalizues konsiderohen gjithashtu personat që punojnë nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e kontraktorëve, nënkontraktorëve ose furnitorëve, punonjësit në sektorin publik dhe privat, personat e vetëpunësuar, si dhe individët që janë pjesë e organeve drejtuese, administrative apo mbikëqyrëse të një subjekti, përfshirë anëtarët jo-drejtues.

Projektligji u njeh sinjalizuesve një sërë të drejtash thelbësore, përfshirë: të drejtën e konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit dhe mbrojtjen nga çdo formë hakmarrjeje.

Mekanizmi i sinjalizimit ndërtohet mbi dy shtylla kryesore:

- (i) **parashikimin e një procedure të re ligjore** për shqyrtimin e pretendimeve të sinjalizimit mbi shkeljet e mundshme; dhe
- (ii) **vendosjen e masave mbrojtëse** ndaj sinjalizuesve kundër çdo forme hakmarrjeje të ushtruar nga autoritetet publike ose subjektet private, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshirë kërcënimet, masat diskriminuese, disiplinore apo çdo veprim tjetër të padrejtë që cenon interesat e ligjshëm të sinjalizuesit si pasojë e raportimit.

Shtylla e parë: trajtimi i sinjalizimit

Një nga risitë e projektaktit është zgjerimi i objektit të sinjalizimit dhe fushëzbatimit të tij, ku përfshirja e çdo shkelje të mundshme të kuadrit ligjor shkon përtej objektit të ligjit aktual në fuqi. Fusha e zbatimit të këtij projektligji përfshin jo vetëm veprime të kundërligjshme që përbëjnë shkelje të dispozitave të legjislationit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, por edhe të normave të nxjerra nga organizata ndërkombëtare, në rastet kur, nëpërmjet një marrëveshjeje të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i këtyre normave në fushat e mëposhtme:

- a) përdorimi i fondeve të buxhetit të shtetit, Bashkimit Evropian apo organizatave ndërkombëtare, si dhe çdo veprim ose mosveprim që cenon ose mund të cenojë interesat financiare të Bashkimit Evropian, në kuptim të nenit 325 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;
- b) prokurimi publik;

- c) shërbimet financiare, produktet dhe tregjet financiare, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit;
- ç) shkeljet që lidhen me rregullat e tregut të brendshëm sipas nenit 26 paragrafi 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë shkeljet e rregullave të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, rregullat mbi tatimin e fitimit apo marrëveshjet që synojnë përfitim tatimor në kundërshtim me përcaktimet ligjore;
- d) siguria dhe përputhshmëria e produkteve;
- dh) siguria e transportit;
- e) mbrojtja e mjedisit;
- ë) mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
- f) siguria ushqimore dhe ushqimit për kafshë, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve
- g) shëndeti publik
- gj) mbrojtja e konsumatorit
- h) mbrojtja e të dhënave personale, privatësia dhe siguria e rrjeteve dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Në vijim, një tjetër risi është dhe detyrimi ligjor për ngritjen e njësisë përgjegjëse për të gjithë autoritetet publike dhe subjektet private të cilat kanë më shumë se 50 punonjës. Këto njësi do të shërbejnë si një structure e posaçme, e caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, e ngarkuar me detyrën e shqyrtimit dhe hetimit të sinjalizimit deri në përfundimin e çështjes. Përcaktimi për ngritjen e njësive përgjegjëse **pranë autoriteteve publike dhe subjekteve private** me një prag më të ulët punonjësish, krahasuar me ligjin aktual (nga 80 në 50 punonjës), e bën këtë projektligj më gjithëpërfshirës dhe rrit ndjeshëm numrin e njësive përgjegjëse që do të krijohen. Si rezultat, më shumë autoritete publike dhe subjekte private, të cilat deri më tani nuk kanë qenë pjesë e raportimeve do të përfshihen në zbatimin e detyrimeve të këtij projektligji. Për garantimin e zbatimit të këtij detyrimi, projektligji parashikon masa administrative, përfshirë sanksione në rast të moskrijimit të njësive përgjegjëse. Në rast përsëritjeje të shkeljes, aplikohet masë rënduese në vlerën 500.000 lekë.

Gjithashtu, një risi e rëndësishme e këtij projektligji është vendosja e detyrimit për ngritjen e njësive përgjegjëse për sinjalizimin pranë autoriteteve publike dhe subjekteve private, pavarësisht numrit të punonjësve, për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushat e shërbimeve financiare, produkteve dhe tregjeve financiare, sigurimeve dhe fondeve të pensionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe në çdo fushë tjetër të parashikuar nga aktet e Bashkimit Evropian që kërkojnë ngritjen e kanaleve të brendshme të raportimit.

Njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve. Si njësitë përgjegjëse, ashtu edhe ILDKPKI, kanë detyrimin ligjor të sigurojnë kapacitetet e nevojshme profesionale dhe institucionale për trajtimin e sinjalizimeve dhe kryerjen e procedurave të hetimit administrativ.

Sinjalizimi i çdo shkeljeje të mundshme të kuadrit ligjor mund të kryhet në tre mënyra:

- **përmes sinjalizimit të brendshëm**, pranë njësisë përgjegjëse të ngritur në autoritetin publik ose subjektin privat;
- **përmes sinjalizimit të jashtëm**, pranë autoritetit kompetent - Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI);
- **përmes sinjalizimit publik**, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në këtë projektligj.

Risi e rëndësishme e projektligjit është garantimi i ndihmës juridike falas, në përputhje me Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky parashikim përfshihet në të drejtat e sinjalizuesit dhe përbën një instrument shtesë, efektiv dhe mbrojtës në favor të tij. Kjo risi forcon më tej mekanizmat mbrojtës të parashikuar në projektligj, duke e fuqizuar sinjalizuesin në përballimin e pasojave të mundshme të sinjalizimit dhe duke e inkurajuar atë të veprojë me besim dhe siguri juridike.

Në tërësi, projektligji synon krijimin e një ambienti të sigurt dhe të besueshëm, në të cilin sinjalizuesi të ndihet i lirë të zgjedhë mekanizmin e raportimit. Edhe pse ligji parashikon tre mënyra sinjalizimi, të brendshëm, të jashtëm ose publik, fryma e përgjithshme e projektligjit inkurajon sinjalizimin e brendshëm si mjetin më efikas për trajtimin e problematikave brenda mjedisit të punës, përmes strukturave të ngritura si njësitë përgjegjëse.

Kjo qasje pritet të luajë një rol thelbësor në adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të brendshme, si dhe në përmirësimin e funksionimit të autoriteteve publike dhe subjekteve private, duke rritur efektivitetin dhe besimin në këto institucione.

Në këtë kuadër, projektligji përcakton qartë se sinjalizues është çdo individ që ka ose ka pasur një marrëdhënie pune me autoritetin publik ose subjektin privat, përfshirë punonjësit, punëkërkuessit, ish-punonjësit, si dhe personat që kryejnë punë si vullnetarë apo praktikantë, pavarësisht natyrës apo kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës dhe nëse ajo është e paguar apo jo.

Gjithashtu, projektligji vendos disa parime thelbësore në udhëheqjen e ligjit për sinjalizimin si; Parimi i Integritetit dhe Konfidencialitetit, sipas të cilit pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi: **Parimi i Llogaridhënies**, sipas të cilit organet publike, janë përgjegjëse për veprimet, mosveprimet dhe vendimet e tyre, për pasojat e këtyre veprimeve, si dhe kanë detyrimin që në lidhje me sinjalizimin të paraqesin të dhëna dhe informacione mbi faktet e sinjalizuara; **Parimi i Paanshmërisë**, sipas të cilit shqyrtimi dhe zgjidhja e sinjalizimeve bëhen pa subjektivitet, pavarësisht nga bindjet dhe interesat e personave përgjegjës për zgjidhjen e tyre; **Parimi i Pavarësisë** sipas të cilit sipas të cilit mekanizmat e sinjalizimit janë funksional dhe garantojnë ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit, kufizimin e aksesit për personelin e paautorizuar, si dhe lejojnë ruajtjen sistematike të informacionit për të vijuar me hetime të mëtejshme; **Parimi i Efijencës**, sipas të cilit burimet njerëzore, financiare dhe

institucionale përdoren në mënyrë optimale për të siguruar arritjen e objektivave me kosto të ulët, brenda afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar.

Sipas frymës së projektligjit dhe si një risi e tij, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja do të fillojnë shqyrtimin dhe hetimin e çdo sinjalizimi, përfshirë edhe sinjalizimet anonime, të kryera në përputhje me parashikimet e këtij projektligji. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit lejohet vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente.

Për të orientuar dhe lehtësuar çdo individ që kryen një sinjalizim, projektligji parashikon një sërë të dhënash që mund të plotësohen nga sinjalizuesi, për aq sa ai zotëron informacion. Ky strukturim i informacionit synon të mundësojë identifikimin e qartë të problematikës nga njësia përgjegjëse ose autoriteti kompetent. Për aq sa është e mundur, sinjalizimi shoqërohet me dokumentacion mbështetës; të dhënat e identitetit dhe kontaktit të sinjalizuesit (përveç rasteve të sinjalizimit anonim); identifikimin e organit ose personit të sinjalizuar; përshkrimin e shkeljes së mundshme të kuadrit ligjor, të bazuar në fakte, rrethana dhe dokumentacion mbështetës; si dhe referencën e dispozitave të shkelura, nëse kjo është e mundur.

Projektligji përcakton se sinjalizimi është në çdo rast vullnetar. Kjo nënkupton se individ i është lirë të zgjedhë të sinjalizojë sipas këtij projektligji, të paraqesë kallëzim pranë prokurorisë ose policisë, ose të bëjë publike çështjen në media, pa qenë i detyruar të ndjekë procedurat e këtij ligji. Megjithatë, individët që zgjedhin të sinjalizojnë jashtë kushteve të parashikuara këtu, nuk përfitojnë mbrojtjen që ky ligj garanton.

Hetimi i sinjalizimit bazohet në parime të procesit të rregullt ligjor, shkelja e të cilave përbën kundërvajtje administrative dhe sjell përgjegjësi për punonjësit ose autoritetet publike apo subjektet private. Këto parime përfshijnë: ndershmërinë, paanshmërinë dhe efikasitetin; pavarësinë nga ndikimet politike ose çdo ndikim i padrejtë; shmangien dhe deklarimin e konfliktit të interesit në lidhje me sinjalizimin; mbrojtjen e dokumentacionit dhe provave nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi apo çdo ndërhyrje tjetër që synon cënimin e tyre; ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit; ruajtjen e sekretit shtetëror sipas legjislacionit përkatës; si dhe mbrojtjen e të dhënave personale që përmban sinjalizimi.

Mënyra e garantimit të paanshmërisë së njësive përgjegjëse vlerësohet rast pas rasti. ILDKPKI-ja, e cila do të monitorojë zbatimin e projektligjit dhe do të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse, do të përcaktojë në këto akte mënyrat dhe treguesit konkretë për sigurimin e paanshmërisë së punonjësve të njësive përgjegjëse.

Për të shmangur çdo konfuzion në lidhje me kompetencat e organeve të ndjekjes penale, projektligji përcakton qartë se njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja shqyrtojnë vetëm pretendimet e sinjalizuesit dhe natyrën e shkeljes së raportuar. Kur gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi është i bazuar dhe përmban elementë të veprës penale, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja pushon shqyrtimin administrativ dhe njofton menjëherë prokurorinë ose policinë. Ndërsa kur shkelja e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë shkelje administrative, rasti i referohet organit kompetent

administrativ, i cili vijon trajtimin sipas legjislacionit në fuqi. Projektligji kufizohet vetëm në detyrimin për të informuar organet përgjegjëse, pa u ndërhyrë në kompetencat e tyre të mëtejshme.

Ngritja e mekanizmave të përshtatshëm për hetimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve është një element thelbësor i projektligjit dhe përbën detyrim ligjor si për ILDKPKI-në, ashtu edhe për njësitë përgjegjëse. Së pari, njësitë përgjegjëse kanë detyrimin të raportojnë çdo vit te ILDKPKI-ja për zbatimin e ligjit; në rast mosraportimi, ato sanksionohen. Së dyti, këto raportime shërbejnë si bazë për hartimin e rekomandimeve nga ILDKPKI-ja. Edhe pse rekomandimet nuk kanë efekt detyrues, ato kanë karakter orientues, udhëzues dhe shpjegues, duke ndihmuar strukturat zbatuese për përmirësimin e punës dhe krijimin e praktikave të unifikuara.

Gjithashtu, projektligji parashikon se ILDKPKI-ja do të nxjerrë udhëzime me efekt detyrues për zbatimin e tij brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Shtylla e dytë: mbrojtja nga veprimet hakmarrëse

Një risi e rëndësishme e projektligjit është përcaktimi se trajtimi dhe shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse i takon ekskluzivisht autoritetit kompetent, ILDKPKI-së, sipas parashikimeve të këtij projektakti. Pavarësisht nëse sinjalizimi është kryer pranë njësisë përgjegjëse ose përmes sinjalizimit publik, kërkesa për marrjen e masave mbrojtëse kundër hakmarrjes mund të paraqitet vetëm pranë ILDKPKI-së. Ky parashikim përforcon mekanizmin e mbrojtjes që projektligji synon t'i garantojë sinjalizuesit dhe siguron mbrojtje efektive për çdo individ që kryen sinjalizim.

Veprim hakmarrës do të konsiderohet çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i ndërmarrë në një kontekst pune, që ndodh pasi një individ ka sinjalizuar ose planifikon të sinjalizojë një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor përmes mekanizmave të brendshëm, të jashtëm ose publikisht, që shkakton ose mund të shkaktojë dëm për sinjalizuesin. Të tilla mund të jenë a) shkarkimi nga puna; b) pezullimi nga detyra; c) transferimi brenda ose jashtë institucionit; ç) ulja në detyrë; d) ulja e pagës dhe shpërblimeve financiare; dh) humbja e statusit profesional ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin; e) mohimi i mundësisë për ngritje në detyrë; ë) përjashtimi nga programet e trajnimit; f) vlerësimi negativ në marrëdhënien e punës; g) intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik apo përjashtimi nga ambienti i punës; gj) diskriminimi ose trajtimi i padrejtë; h) mosrinovimi i kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm; i) përfundimi ose mosrinovimi i kontratës së përkohshme; j) dëmtimi i reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbja e të ardhurave apo mundësive të biznesit; k) përfshirja në “listë të zezë”, përmes marrëveshjeve formale ose informale që pengojnë punësimin në sektorin përkatës në të ardhmen; l) përfundimi ose anulimi i parakohshëm i kontratës për mallra ose shërbime; ll) anulimi i licencës ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit; m) referimi i pajustificuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor; n) kërcënimi ose përpjekja për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme; si dhe nj) izolimi profesional, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse apo marginalizimi i heshtur në ambjentet e punës.

Listimi i këtyre veprimeve duke shtuar një sërë veprimesh të tjera të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në ligjin aktual, zgjerojnë dhe afektojnë pozitivisht mbrojtjen e sinjalizuesit në kuptim të këtij projektligji.

Në vijim të sa më sipër, një risi e projektligjit është dhe mbrojtja e ndihmësit, personave të lidhur me sinjalizuesin si dhe personat juridikë që sinjalizuesi zotëron, përfaqëson, punon ose ka një marrëdhënie biznesi me të, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes, nëse ndaj tyre janë ushtruar ose është tentuar të ushtrohen veprime hakmarrëse. Ky parashikim shtrin mbrojtjen e sinjalizuesit në një tjetër nivel, duke i garantuar dhe mbrojtjen e individëve apo subjekteve të tjerë. Po ashtu, në përputhje dhe në zbatim me këtë ligj, mbrojtje i ofrohet edhe personave që raportojnë pranë institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit Evropian për shkelje që hyjnë në fushën e këtij ligji, njëjtësi personat që kryejnë sinjalizim të jashtëm.

Neni 9 i projektligjit për sinjalizimin parashikon ndalimin e çdo forme hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit apo personave të lidhur me të, duke garantuar mbrojtje të plotë ligjore për çdo individ që vepron në përputhje me ligjin për sinjalizimin. Ky nen ndalon qartësisht çdo veprim që synon pengimin, ndërhyrjen, përpjekjen apo kërcënimin për të penguar procesin e sinjalizimit, pavarësisht nga forma apo mjeti i përdorur. Çdo kontratë, marrëveshje apo rregull që përpiqet të kufizojë apo ndalojë të drejtën për sinjalizim konsiderohet e pavlefshme dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik.

Në mënyrë të veçantë, ndalohen të gjitha veprimet hakmarrëse, qoftë të drejtpërdrejta apo të tërthorta, përfshirë edhe përpjekjet apo kërcënimet për hakmarrje, kundrejt sinjalizuesit apo individëve të lidhur me të. Kjo mbrojtje shtrihet pavarësisht nga forma e sinjalizimit, qoftë ai i brendshëm, i jashtëm, anonim apo publik. Ky nen forcon mbrojtjen efektive të sinjalizuesve dhe kontribuon në krijimin e një ambienti të sigurt për raportimin e shkeljeve, pa frikë nga pasoja personale apo profesionale.

Në lidhje me paligjshmërinë e veprimeve hakmarrëse ndaj sinjalizuesit formalizuar si akt administrativ, neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se akti administrativ është “absolutisht i pavlefshëm në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”. Nga ana tjetër, si për shembull edhe në rastet e largimit nga puna sipas Kodit të Punës, i ndryshuar, pushimi nga puna për shkaqe të paarsyeshme është i pavlefshëm.

Megjithatë, pavlefshmëria e veprimeve hakmarrëse sanksionuar në projektligj është gjithmonë e lidhur me mbrojtjen e ofruar sinjalizuesit sipas këtij projektligji. Kështu, nëse në perfundim të hetimit rezulton se është kryer një veprim hakmarrës ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, ILDKPKI-ja i drejtohet organit kompetent sipas legjisllacionit në fuqi për të urdhëruar autoritetin publik të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Në këtë kuptim, organi kompetent mund të jetë organi epror ose një organ i administratës publike i cili ka tagër sipas ligjit për të revokuar një akt apo rishqyrtuar dhe korrigjuar veprimin e paligjshëm, sikurse është veprimi hakmarrës sipas përcaktimeve të këtij projektligji. Nëse në perfundim të hetimit rezulton se është

kryer një veprim hakmarrës ndaj sinjalizuesit nga subjekti privat, ILDKPKI-ja urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Nëse organi kompetent apo subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Pra, investimi i gjykatës është mjeti i fundit në zinxhirin e masave efektive për mbrojtjen e sinjalizuesit.

Ndërkaq, në çdo procedurë gjyqësore ose administrative që ka të bëjë me veprime hakmarrëse, pasi sinjalizuesi ka bërë një sinjalizim dhe ka pësuar dëm, do të supozohet se dëmi është rezultat i hakmarrjes dhe në këtë rast, barra e provës rëndon mbi punëdhënësin për të provuar të kundërtën.

Neni 10 i projektligjit për sinjalizimin parashikon ruajtjen e konfidencialitetit dhe detyrimi që kanë njësitë përgjegjëse për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit. Në mënyrë të veçantë, punonjësit e njësisë përgjegjëse dhe po ashtu njësia pranë ILDKPKI kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe informacionit të marrë nga sinjalizimi, dhe të mos i përdorin apo zbulojnë ato për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e këtij ligji; Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara prej tyre mund të bëhen pa pëlqimin e tij, por vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar dhe proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor. Dhe në një rast të tillë, ILDKPKI apo njësia përgjegjëse i dërgon sinjalizuesit një njoftim me shkrim që përmban arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, paragrafi 1, të Kushtetutës.

Në zbatim të vendimit nr. 29, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin” pika 3, gërma “b” Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji, ndaj edhe nisma e propozuar, paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës.

Projektligji i propozuar është në përputhje edhe me parimet e përgjithshme të legjislacionit vendas e ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrim të plotë me *acquis* dhe konkretisht transpozimin e Direktivës (BE) 2019/1937 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, mbi mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të së drejtës së Bashkimit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 7 krerë dhe 30 nene.

Kreu I, përcakton dispozitat e përgjithshme që përfshijnë objektin, qëllimin, fushën e zbatimit dhe përkufizimet e termave të projektligjit, të tilla si: “sinjalizues”, “person i përfshirë”, “sinjalizim” “sinjalizim i brendshëm”, “sinjalizim i jashtëm”, “sinjalizim publik”, “shkelje”, “informacion mbi shkelje”, “veprime hakmarrëse”, “përgjigje”, “kontekst pune” etj., si dhe parimet bazë të procesit të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesit. Më konkretisht, nenet 1-5, kanë të adresuar risitë dhe harmonizimin e neneve të Direktivës së BE, dhe sidomos referuar fushës së veprimit për raste kur shkeljet dhe raportimet janë edhe për përdorim të fondeve të buxhetit të shtetit, Bashkimit Evropian apo organizatave ndërkombëtare si dhe çdo veprim ose mosveprim që cenon ose mund të cenojë interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe specifikisht referuar parashikimeve të neneve 325 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, për raste të shkeljeve të rregullave të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, rregullat mbi tatimin e fitimit apo marrëveshjet që synojnë përfitim tatimor në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Kreu II, neni 6 parashikon të drejtën për mbrojtje. Ky nen vendos bazat për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke garantuar siguri ligjore dhe institucionale kundër çdo forme hakmarrjeje që mund të lindë si pasojë e procesit të sinjalizimit. Mbrojtja e tyre sigurohet përmes mekanizmave specifikë të përcaktuar në këtë ligj. Sinjalizuesit u garantohet një sërë të drejtash thelbësore, përfshirë: Mbrojtjen nga hakmarrja, në të gjitha format e saj; Ruajtjen e konfidencialitetit dhe të identitetit, edhe në rastet e sinjalizimeve anonime; Mbrojtjen e burimit të informacionit të sinjalizuar; Ndihmë juridike falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi; Të drejtën për kompensimin e dëmit, në rast të veprimeve hakmarrëse.

Mbrojtja nuk kufizohet vetëm tek sinjalizuesi, por shtrihet edhe tek ndihmësit e tij, personat e lidhur, si dhe subjektet juridike me të cilat ai ka lidhje pronësie apo bashkëpunimi. Nëse këta persona përballen me hakmarrje apo kërcënime të tilla, ata përfitojnë të njëjtën mbrojtje.

Garancitë për të drejtat e sinjalizuesit zbatohen në tri faza: gjatë hetimit administrativ, pas përfundimit të tij për të siguruar rikthimin në detyrë apo vijimësinë e punës, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nëse sinjalizuesi kërkon mbrojtje mbi bazë të rrethanave të arsyeshme.

Gjithashtu, çdo marrëveshje apo rregull privat që synon të kufizojë apo përjashtojë këto të drejta është e pavlefshme. Ligji i jep përparësi absolute të drejtave të sinjalizuesit ndaj çdo marrëveshjeje për konfidencialitet.

Autoritetet publike, subjektet private dhe vetë ILDKPKI kanë detyrimin të informojnë sinjalizuesin për të drejtat dhe mbrojtjen që i garantohet me ligj, duke forcuar rolin parandalues dhe mbështetës të institucioneve.

Neni 7, parashikon kushtet të cilat sinjalizuesi gëzon mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht mënyrës së zgjedhur për të kryer raportimin e sinjalizimit, përfshirë këtu edhe sinjalizimin anonim apo publik. Kushtet e parashtruara janë kumulative dhe përfshijnë shkaqe të arsyeshme për të besuar

se informacioni i sinjalizuar apo i bërë publik për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor ishte i saktë dhe i vërtetë në momentin e sinjalizimit ose publikimit; informacioni i sinjalizuar përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji dhe sinjalizimi është kryer në përputhje me dispozitat e këtij ligji, përmes një mekanizmi të brendshëm, të jashtëm ose përmes publikimit të informacionit. sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje edhe nëse identiteti i tij është zbuluar më vonë pa pëlqimin e tij të shprehur dhe është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse. Sinjalizuesi që sinjalizon publikisht një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, në fushat e përcaktuara në sipas përcaktimeve të këtij ligji, gëzon të drejtën për mbrojtje në të njëjtat kushte. Gjithashtu gëzojnë të drejtën për mbrojtjen e parashikuar në këtë ligj në të njëjtat kushte si personat që raportojnë në mënyrë të jashtme, edhe personat që raportojnë pranë institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit Evropian shkelje që hyjnë në fushën e këtij ligji.

Neni 8, vijon me mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse që sinjalizuesi gëzon ndaj çdo veprimi hakmarrës të ndërmarrë nga autoriteti publik ose subjekti privat kundrejt tij, si:

- a) shkarkimi nga puna;
- b) pezullimi nga detyra;
- c) transferimi i detyrave, ndryshimi i vendndodhjes së punës, uljes së pagave dhe ndryshimi i orarit të punës;
- ç) ulja në detyrë;
- d) ulja e pagës dhe shpërblimeve financiare;
- dh) humbja e statusit profesional ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin;
- e) mohimi i mundësisë për ngritje në detyrë;
- ë) përjashtimi nga programet e trajnimit;
- f) vlerësimi negativ në marrëdhënien e punës;
- g) intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik apo përjashtimi nga ambienti i punës;
- gj) diskriminimi ose trajtimi i padrejtë;
- h) mosrinovimi i kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm;
- i) përfundimi ose mosrinovimi i kontratës së përkohshme;
- j) dëmtimi i reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbja e të ardhurave apo mundësive të biznesit;;
- k) përfshirja në “listë të zezë”, përmes marrëveshjeve formale ose informale që pengojnë punësimin në sektorin përkatës në të ardhmen;
- (l) përfundimi ose anulimi i parakohshëm i kontratës për mallra ose shërbime;
- (ll) anulimi i licencës ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit;
- (m) referimi i pajustificuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor;
- (n) kërcënimi ose përpjekja për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme;
- (nj) izolimi profesional, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse apo marginalizimi i heshtur në ambjentet e punës.

Kërkesat për mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse drejtohen dhe trajtohen pranë autoritetit kompetent nëse ky i fundit vlerëson se sinjalizuesi është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të sinjalizimit.

Nëse sinjalizuesi kërkon zhvendosjen në një njësi tjetër brenda autoritetit publik ose subjektit privat, për shkak të krijimit të një mjedisi pune armiqësor si pasojë e sinjalizimit, autoriteti publik ose subjekti privat merr masat e nevojshme për realizimin e kësaj zhvendosjeje. Gjithashtu, në rast të mosmarrjes së masave, autoriteti kompetent, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet autoritetit publik ose subjektit privat për të urdhëruar marrjen e masave përkatëse. Nëse autoriteti publik ose subjekti privat nuk zbaton masat e urdhëruara brenda një afati prej 10 ditësh kalendarike nga data e marrjes së kërkesës, sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 9, vijon me ndalimin e veprimeve hakmarrëse dhe mbrojtjen e sinjalizuesit. Ligji ndalon rreptësisht çdo veprim hakmarrës ndaj një sinjalizuesi për shkak të sinjalizimit të kryer, pavarësisht nëse ai është bërë në mënyrë të brendshme, të jashtme, anonime apo publike. Çdo përpjekje për të penguar ose kufizuar të drejtën për sinjalizim, përfshirë këtu edhe kontrata që synojnë ta ndalojnë këtë të drejtë, janë të pavlefshme.

Neni 10, parashikon ruajtjen e konfidencialitetit dhe detyrimin për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit. Projektligji parashikon në mënyrë eksplicite mbrojtje të identitetit të sinjalizuesit dhe të dhënave të sinjalizuara. Këto të dhëna mund të përpunohen vetëm nga njësia përgjegjëse dhe autoriteti kompetent dhe mund të zbulohen vetëm me pëlqimin e shprehur të sinjalizuesit, përveç rasteve të përcaktuara me ligj, si në rastin e ndjekjes së procedurave penale. Gjithashtu, të gjitha palët e përfshira kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin dhe të mos i përdorin të dhënat për qëllime të tjera nga ato që parashikon ligji. Dispozita parashikon se zbulimi i identitetit dhe të dhënave mund të bëhet pa pëlqimin e sinjalizuesit, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar dhe proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor. Gjithashtu, kjo dispozitë parashikon se në çdo rast njësia përgjegjëse dhe ILDKPKI njoftojnë paraprakisht sinjalizuesin mbi arsyet e justifikuar për zbulimin e të dhënave konfidenciale dhe masat e marra, për të kufizuar rrezikun e ekspozimit të panevojshëm.

Neni 11, parashikon përpunimin e të dhënave personale. Përpunimi i të dhënave personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ kryhet vetëm për qëllime të zbatimit të këtij projektligji dhe në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale që nuk konsiderohen të nevojshme për trajtimin e një sinjalizimi nuk mblidhen. Nëse këto të dhëna mblidhen rastësisht, ato fshihen pa vonesë. Në rast se gjatë zbatimit të këtij ligji konstatohet shkelje e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të dhënat personale që nuk i shërbejnë trajtimit të sinjalizimit nuk përfshihen në hetimin administrativ.

Neni 12, vijon me administrimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e të dhënave. Projektligji përcakton mënyrat dhe format e regjistrimit të sinjalizimeve, përfshirë ato verbale, përmes telefonit apo takimeve fizike. Në të gjitha rastet, sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e informacionit të dhënë. Dokumentacioni ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga përfundimi i procedurës së sinjalizimit, duke garantuar gjurmueshmëri dhe mbrojtje të të dhënave personale.

Kreu III, vijon me nenin 13, procedura e sinjalizimit dhe hetimi administrativ. Sinjalizimi mund të bëhet: Brenda institucionit (sinjalizim i brendshëm pranë njësite përgjegjëse të institucionit

përkatës), drejtëpërdrejtë pranë autoritetit kompetent (sinjalizim i jashtëm i cili mund të mund të bëhet në çdo fazë dhe pa u kushtëzuar nga raportimi paraprak i brendshëm), në mënyrë verbale (përmes një linje telefonike të dedikuar, anonime ose publike. Sinjalizimi, sipas rastit shoqërohet me të dhëna identifikuese, përshkrim të shkeljes, dokumentacion mbështetës dhe, kur është e mundur, referenca të legjislacionit të shkelur.

Hetimi administrativ për sinjalizimin duhet të përfundojë brenda 90 ditëve, me të drejtë për pjesëmarrje dhe mbrojtje të të drejtave të palëve të përfshira.

Neni 14, i ligjit përcakton detyrimin e autoriteteve publike dhe subjekteve private me më shumë se 50 punonjës, si dhe të enteve me kapital shtetëror apo nën kontroll shtetëror, për krijimin e një njësie përgjegjëse për sinjalizimin. Kjo njësi ka për detyrë të garantojë funksionimin efektiv të një mekanizmi të dedikuar për raportimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve të brendshme, në përputhje me legjislacionin përkatës. Autoritetet dhe subjektet përkatëse duhet të miratojnë një rregullore të brendshme që rregullon procedurat e sinjalizimit dhe të informojnë punonjësit për mënyrat e aksesit dhe përdorimit të këtij mekanizmi, i cili duhet të mbulojë të gjitha format e sinjalizimit, përfshirë ato verbale, me shkrim ose nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit. Gjithashtu, projektligji parashikon edhe detyrimin e njësive përgjegjëse për të marrë masa dhe kryer ndërgjegjësim me qëllim nxitjen e raportimit përmes kanaleve dhe procedurave të brendshme të sinjalizimit para përdorimit të kanaleve të jashtme, në rastet kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda institucionit dhe kur personi raportues vlerëson se nuk ekziston rrezik hakmarrjeje, si dhe siguron informacionin e nevojshëm mbi përdorimin e këtyre kanaleve, si dhe mbi procedurat për raportim të jashtëm pranë ILDKPKI. Përbërja e njësisë përcaktohet në varësi të madhësisë dhe strukturës së institucionit, ndërkohë që punonjësit e saj duhet të jenë të trajnuar posaçërisht në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Emërimi i tyre bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit me shkrim. Ligji parashikon gjithashtu mundësinë e menaxhimit të mekanizmit nga një palë e tretë e jashtme në sektorin privat, me kusht që të garantohet pavarësia, konfidencialiteti, anonimiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale. Subjektet private që operojnë në të njëjtën fushë dhe kanë nga 50 deri në 249 punonjës mund të krijojnë një njësi të përbashkët, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën për informim. Nga ky detyrim përjashtohen bashkitë me më pak se 10,000 banorë ose më pak se 50 punonjës. Gjithashtu, risi e këtij projektligji është edhe detyrimi për ngritjen e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin, pavarësisht nga numri i punonjësve, për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushat e shërbimeve financiare, të produkteve dhe tregjeve financiare, të sigurimeve dhe fondeve të pensionit, të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe në çdo fushë tjetër të parashikuar nga aktet e Bashkimit Evropian që kërkojnë ngritjen e kanaleve të brendshme të raportimit.

Njësitë përgjegjëse kanë gjithashtu detyrimin të dorëzojnë pranë ILDKPKI-së, brenda datës 15 janar të çdo viti, raportin vjetor të konsoliduar mbi sinjalizimet e trajtuara, sipas formatit të miratuar nga ky institucion.

Neni 15, përcakton detyrimet funksionale të njësisë përgjegjëse për trajtimin e sinjalizimeve të brendshme. Njësia është e ngarkuar të pranojë, të regjistrojë dhe të konfirmojë marrjen e çdo

sinjalizimi brenda një afati prej 7 ditësh nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi kërkon shprehimisht të mos marrë konfirmim ose kur një veprim i tillë do të cënonte mbrojtjen e identitetit të tij. Ajo ka gjithashtu detyrimin të ndjekë me përgjegjësi çështjen dhe të informojë sinjalizuesin për ecurinë dhe rezultatin përfundimtar të sinjalizimit jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit, edhe në rastet kur nuk është dhënë konfirmimi i marrjes. Gjithashtu, njësia përgjegjëse ka detyrimin të sigurojë që kanalet e sinjalizimit të organizohen dhe funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo personi të tretë të përmendur në sinjalizim, si dhe duke parandaluar aksesin e paautorizuar ndaj informacionit të përfshirë në sinjalizim si dhe të sigurojë informacionin e qartë dhe të nevojshëm mbi procedurat e raportimit të brendshëm, përfshirë mënyrën e përdorimit të tyre dhe masat e mbrojtjes për sinjalizuesit. Njësia duhet të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit dhe të dhënave të lidhura me sinjalizimin, përveç rasteve kur zbulimi është i domosdoshëm dhe i përcaktuar me ligj të posaçëm. Punonjësi i caktuar për trajtimin e sinjalizimeve brenda njësisë gëzon pavarësi në ushtrimin e kompetencave të tij, sidomos kur sinjalizimi ka lidhje me punëdhënësin ose përfshin masa për mbrojtjen e sinjalizuesit. Në rast se ky punonjës bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të ushtrimit të detyrës, ai përfiton mbrojtje sipas ligjit. Gjithashtu, nëse një sinjalizim i drejtohet gabimisht një personi të paautorizuar, ky i fundit ka detyrimin ta përcjellë menjëherë dhe pa vonesë sinjalizimin tek punonjësi përkatës i njësisë përgjegjëse ose autoriteti kompetent, duke respektuar gjithmonë parimin e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së identitetit të personit sinjalizues.

Neni 16 i ligjit përcakton rolin dhe detyrat e Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) si autoriteti kompetent për administrimin e sinjalizimeve. Në këtë funksion, ILDKPKI ka detyrimin të pranojë, regjistrojë dhe konfirmojë marrjen e sinjalizimit brenda një afati 7-ditor, me përjashtim të rasteve kur sinjalizuesi kërkon të mos merret konfirmim ose kur një veprim i tillë do të cënonte mbrojtjen e identitetit të tij. Brenda së njëjtës periudhë, ILDKPKI harton një raport për të vlerësuar nëse të drejtat e sinjalizuesit janë shkelur apo janë vënë në rrezik, si dhe vlerëson nevojën për marrjen e masave të përkohshme mbrojtëse ndaj sinjalizuesit në rast se konstaton rrezik për veprime hakmarrëse. Autoriteti kompetent ndjek hetimin e çështjes në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, informon sinjalizuesin për rezultatet përfundimtare dhe trajton kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja. ILDKPKI garanton mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave të sinjalizuesit, siguron akses në informacion dhe udhëzon publikun mbi procedurat e sinjalizimit nëpërmjet dokumentacionit të qartë dhe të aksesueshëm. Gjithashtu, krijon mekanizma të jashtëm, të pavarur dhe funksionale për trajtimin e sinjalizimeve, duke garantuar komunikim të vazhdueshëm me sinjalizuesin dhe institucionet përkatëse. Autoriteti ofron mbështetje për sinjalizuesit përmes këshillimit dhe orientimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. ILDKPKI ka të drejtë të vendosë për mbylljen e një procedure kur nuk konstaton shkelje ose kur sinjalizimi përsëritet pa sjellë informacione të reja me vlerë. Në rastet kur përballet me një fluks të lartë sinjalizimesh, autoriteti u jep përparësi atyre që kanë lidhje me çështje me interes të lartë publik. Çdo institucion që merr një sinjalizim jashtë kompetencës së tij, ka detyrimin ta përcjellë atë pranë ILDKPKI-së dhe të njoftojë sinjalizuesin duke respektuar konfidencialitetin dhe siguruar ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit dhe po ashtu të çdo informacioni që mund ta zbulojë atë. Për realizimin e këtyre funksioneve, ILDKPKI angazhon personel të trajnuar posaçërisht për pranimin, ndjekjen dhe komunikimin me sinjalizuesit gjatë gjithë procesit administrativ.

Neni 17 i ligjit rregullon mënyrën e trajtimit të sinjalizimeve anonime, njësoj sikurse çdo sinjalizim tjetër, pa pasur nevojë për kushte shtesë për marrjen, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre. Kërkohej që sinjalizimi anonim të bëhet përmes mekanizmit të brendshëm, të jashtëm ose përmes publikimit. Sipas këtij neni, identiteti i sinjalizuesit mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose në rastet kur kërkohej nga organet procedurale kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sinjalizimi anonim mund të kryhet përmes të gjithë mekanizmave të parashikuar në këtë projektligj. Ligji parashikon gjithashtu mbrojtje për personat që kanë kryer sinjalizim në mënyrë anonime dhe që identifikohej më pas pa pëlqimin e tyre, nëse për shkak të sinjalizimit bëhen objekt i veprimeve hakmarrëse.

Neni 18 i ligjit parashikon kushtet në të cilat një sinjalizim i bërë publikisht nga një sinjalizues përfiton mbrojtje sipas kuadrit ligjor në fuqi. Mbrojtja ligjore ofrohet kur sinjalizuesi ka ndjekur fillimisht procedurat për sinjalizim të brendshëm dhe/ose të jashtëm, ose ka paraqitur një sinjalizim të drejtpërdrejtë pranë autoritetit kompetent, por brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e çështjes. Po ashtu, mbrojtja zbatohet edhe kur sinjalizuesi ka arsye të bazuara për të besuar se shkelja përbën një rrezik të menjëhershëm apo serioz për dëme të pakthyeshme në shëndetin publik, sigurinë, mjedisin ose interesin publik; ose adresimi efektiv i shkeljes është i kufizuar për shkak të rrethanave të veçanta, siç janë rastet kur ekziston rreziku që provat të fshihen ose shkatërrohen, ose kur autoriteti kompetent është bashkëpunëtor me të sinjalizuarin ose është vetë i përfshirë në shkelje. Kjo dispozitë synon të balancojë nevojën për transparencë me garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesit edhe në rastin e publikimit të informacionit.

Neni 19 i ligjit përcakton rolin mbikëqyrës dhe informues të Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), si autoriteti kompetent për ndjekjen e zbatimit të legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. ILDKPKI ka përgjegjësinë të mbikëqyrë zbatimin e ligjit dhe të ofrojë informacion të detajuar dhe të aksesueshëm mbi përmbajtjen dhe procedurat që rrjedhin prej tij. Ky institucion raporton një herë në vit para Kuvendit për ecurinë e zbatimit të ligjit dhe masat e marra në mbrojtje të sinjalizuesve, në kuadër të raportimit vjetor institucional. ILDKPKI publikon në faqen e saj zyrtare një sërë informacionesh të rëndësishme, përfshirë: kushtet për përfitimin e mbrojtjes ligjore; të dhënat e kontaktit për paraqitjen e sinjalizimeve, si dhe procedurat për hetimin e tyre; mënyrën e bashkëpunimit me njësitë përgjegjëse dhe kërkesat për informacion shtesë nga sinjalizuesit; mjetet ligjore kundër veprimeve hakmarrëse; rrethanat në të cilat sinjalizuesit përjashtohen nga përgjegjësia për shkeljen e konfidencialitetit; dhe kontrollin mbi funksionimin e mekanizmave të raportimit të brendshëm dhe të jashtëm. Po ashtu, ILDKPKI është përgjegjës për konstatimin e kundërvajtjeve administrative, vendosjen e sanksioneve, dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të ligjit, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes institucionale, si dhe organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuëse për çështjet që lidhen me sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si edhe rastet e konfidencialitetit të zbatueshëm për sinjalizimet, përfshirë informacionin mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, bazën ligjore dhe qëllimin e përpunimit, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe të drejtat e subjekteve në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. ILDKPKI, sipas këtij projektligji, rishikon periodikisht zbatimin e tij, trajtimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve, të paktën një herë në tre vjet. Kjo mundësohet

nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga njësitë përgjegjëse dhe bashkëpunimit me autoritetet publike duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e sistemit të sinjalizimit.

Neni 20 i projektligjit përcakton rregullat procedurale për zhvillimin e hetimit administrativ mbi sinjalizimet për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor. Hetimi kryhet nga njësia përgjegjëse ose autoriteti kompetent, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Kodit të Procedurave Administrative, dhe duhet të përfundojë brenda një afati maksimal prej 90 ditësh nga data e fillimit të tij. Gjatë hetimit, shqyrtohen me kujdes pretendimet e sinjalizuesit dhe mund të kërkohet dokumentacion shtesë, të zhvillohen inspektime apo intervista me persona që zotërojnë informacion mbi çështjen, si dhe të angazhohen ekspertë të jashtëm kur vlerësohet e nevojshme. Sinjalizuesi dhe palët e treta përfshihen në proces nëse posedojnë informacione të rëndësishme, përfshirë edhe personin e sinjalizuar, në varësi të vlerësimit të drejtuesit të hetimit. Të gjitha palëve pjesëmarrëse u garantohej një proces i rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur deklaratime me shkrim, për t'u njohur me dosjen e hetimit (pa identifikuar sinjalizuesin), si dhe për t'u dëgjuar mbi çështjen. Subjektet publike dhe private janë të detyruara të bashkëpunojnë me hetimin duke vënë në dispozicion çdo provë të kërkuar. Sinjalizuesi duhet të njoftohet për çdo masë të marrë jo më vonë se 30 ditë nga data e vendimmarrjes, dhe çdo kërkesë e tij me shkrim për informim duhet të marrë përgjigje brenda të njëjtës periudhë. Nëse hetimi administrativ konstaton se sinjalizimi është i bazuar dhe përbën shkelje administrative, njësia përgjegjëse referon çështjen pranë autoritetit kompetent. Institucionet publike dhe subjektet private miratojnë rregullore të brendshme për zhvillimin e hetimit administrativ dhe garantimin e konfidencialitetit, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e ILDKPKI-së. Për sinjalizimet që lidhen me pasurinë dhe konfliktin e interesit, në përputhje me ligjet përkatëse (ligji nr. 9049/2003 dhe ligji nr. 9367/2005), autoritet kompetent për trajtimin e tyre është ILDKPKI.

Neni 21, përcakton rrethanat në të cilat njësia përgjegjëse ose autoriteti kompetent mund të vendosë mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ për sinjalizimet e paraqitura. Hetimi nuk fillohet kur sinjalizimi nuk plotëson kriteret formale të ligjit, përjashtohet vetëm sinjalizimi anonim, dhe kur sinjalizuesi nuk korrigjon gabimet brenda 7 ditëve nga njoftimi. Gjithashtu, mosfillimi vendoset kur sinjalizimi përmban fakte jashtë fushës së ligjit ose kur nga verifikimi paraprak rezulton se nuk ka elementë të kundërvajtjes administrative apo veprës penale.

Hetimi administrativ përfundon kur gjatë tij konstatohet se sinjalizimi është i bazuar dhe referohet pranë autoritetit kompetent përkundrejt kundërvajtjeve administrative, ose pranë organeve të prokurorisë në rast dyshimi për veprë penale, duke mbrojtur identitetin e sinjalizuesit me të dhëna anonime. Hetimi përfundon gjithashtu nëse sinjalizimi rezulton i pabazuar, ose kur sinjalizuesi ka dhënë me vetëdije informacion të rremë apo të pasaktë.

Në dosjen e sinjalizimit dokumentohen vendimet për mosfillim ose përfundim të hetimit, arsyet që i shoqërojnë, si dhe masat e marra. Edhe në rastet kur hetimi nuk fillohet, autoriteti kompetent ka detyrimin të dërgojë materialin tek organi kompetent sipas fushës së juridiksionit për veprime të mëtejshme.

Kreu IV, vijon me nenin 22, i cili parashikon procedurën e hetimit të kërkesës për mbrojtje. Kur sinjalizuesi paraqet një kërkesë për mbrojtje ndaj veprimeve hakmarrëse, procedura e hetimit nis menjëherë nga autoriteti kompetent. Ky i fundit regjistron kërkesën dhe e shqyrton atë për të

kuptuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një veprim hakmarrës ka ndodhur, po ndodh apo pritet të ndodhë ndaj sinjalizuesit.

Brenda pesë ditëve nga marrja e kërkesës, autoriteti i njofton sinjalizuesin me shkrim për regjistrimin e saj dhe i jep informacion mbi personin përgjegjës që do të ndjekë çështjen. Në rast se rrezikohet që të kryhen veprime hakmarrëse, brenda shtatë ditëve autoriteti duhet të marrë masa të menjëhershme, duke përfshirë edhe pezullimin e këtyre veprimeve, për të mbrojtur sinjalizuesin deri në përfundim të hetimit. Në këtë rast, vendimi i përkohshëm i njoftohet vetëm sinjalizuesit dhe përjashtimisht kur kërkohet zbatimi i tij me ndërhyrjen drejtëpërdrejtë të institucionit apo subjektit privat.

ILDKPKI, si autoritet kompetent për mbrojtjen e sinjalizuesve, i dërgon sinjalizuesit një njoftim të shkruar brenda shtatë ditëve nga marrja e kërkesës, duke e informuar për statusin e hetimit dhe veprimet procedurale që janë ndërmarrë. Gjithashtu, ILDKPKI është në dispozicion për t'u përgjigjur në çdo kohë ndaj kërkesave të sinjalizuesit për informacion në lidhje me procesin.

Hetimi i kërkesës për mbrojtje duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të saj. Në këtë periudhë, autoriteti publik ose subjekti privat që është përfshirë në hetim duhet, nëse i kërkohet nga ILDKPKI, të provojë se masat e marra ndaj sinjalizuesit nuk kanë lidhje me sinjalizimin që ai ka bërë.

Në fund, ILDKPKI përcakton rregullat e detajuara që do të udhëheqin mënyrën e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse, duke siguruar që çdo rast të trajtohet me seriozitet dhe transparencë.

Neni 23, parashikon mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse. Personat që bëjnë sinjalizim për shkelje të mundshme të ligjit, në përputhje me këtë ligj, nuk konsiderohen shkelës të ndonjë ndalese për publikimin e informacionit dhe nuk mbajnë përgjegjësi ligjore për raportimin apo publikimin e tij, për sa kohë që kanë pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se ishte e nevojshme për të zbuluar një shkelje.

Sinjalizuesit nuk janë përgjegjës ligjërisht për mënyrën se si kanë marrë ose aksesuar informacionin që raportojnë apo publikojnë, përveç nëse ky veprim përbën një vepër penale më vete. Në këto raste, përgjegjësia penale trajtohet sipas ligjit në fuqi.

Çdo përgjegjësi tjetër që mund t'u lindë sinjalizuesve për veprime ose mosveprime që nuk lidhen me sinjalizimin dhe nuk janë të domosdoshme për zbulimin e shkeljes, do të trajtohet sipas legjislacionit specifik përkatës.

Sinjalizuesit, gjithashtu ndihmësit dhe personat e lidhur me sinjalizuesin, kanë të drejtë të përdorin mjete juridike për t'u mbrojtur nga veprimet hakmarrëse, përfshirë edhe marrjen e masave të përkohshme, deri në përfundim të procedurave përkatëse, në përputhje me ligjet në fuqi.

Ndalohet fillimi i procedurave penale, civile apo administrative ndaj sinjalizuesit apo personave të lidhur me të vetëm për shkak të raportimit në përputhje me këtë ligj. Kjo përfshin edhe rastet që

kanë të bëjnë me shpifjen, përgojimin, fyerjen, cenimin e privatësisë dhe të dhënave personale, si dhe shkeljen e sekreteve tregtare apo të drejtave të pronësisë intelektuale apo të drejtën e autorit.

Gjykata, me kërkesë të sinjalizuesit, mund të urdhërojë marrjen e masave të përkohshme për të shmangur pasojat e rënda dhe të pariparueshme që mund të rrjedhin nga veprimet hakmarrëse si dhe sinjalizuesi, ndihmësi apo personat e lidhur me të, kanë të drejtë të kërkojnë komensimin për dëmin e shkaktuar. Ndërkaq, në çdo procedurë gjyqësore ose administrative që ka të bëjë me veprime hakmarrëse, pasi sinjalizuesi ka bërë një sinjalizim dhe ka pësuar dëm, do të supozohet se dëmi është rezultat i hakmarrjes dhe në këtë rast, barra e provës rëndon mbi punëdhënësin për të provuar të kundërtën.

Neni 24, parashikon kompensimin e dëmit në rastet e sinjalizimit në keqbesim Ky nen përcakton kufijtë etikë dhe ligjorë të sinjalizimit, duke mbrojtur integritetin e procesit dhe duke garantuar drejtësi për palët e përfshira. Në thelb, theksohet se sinjalizimi duhet të bëhet me përgjegjshmëri, pa shpifur, mashtruar apo dhënë informacion të rremë në dëm të personave të përfshirë në sinjalizim. Ligji ndalon sinjalizimet abuzive ose të rreme, dhe në rastet e provueshmërisë, personit të përfshirë në sinjalizim i lind e drejta të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Ky përcaktim synon të ruajë balancën mes inkurajimit të sinjalizimit të ndershëm dhe mbrojtjes së individëve nga denoncime të pavërteta.

Neni 25 i projektligjit parashikon mbrojtjen e personave të përfshirë në sinjalizim të cilët gëzojnë të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe proces të rregullt ligjor, duke u mbështetur në parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën për mbrojtje, të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për t'u njohur me dokumentacionin përkatës. Kjo dispozitë gjithashtu përcakton garantimin e mbrojtjes së identitetit të personave të përfshirë, nga ILDKPKI, për sa kohë që hetimet e nisura si rezultat i sinjalizimit janë në proces.

Kreu V, VI dhe VII vijon me nenin 26, i cili parashikon raportimin. Ky nen përcakton detyrimin e ILDKPKI-së për të monitoruar dhe raportuar çdo vit mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin. Raporti vjetor përmban të dhëna të detajuara që lidhen me funksionimin dhe efektivitetin e mekanizmave të sinjalizimit, duke përfshirë: numrin e rasteve të sinjalizuara gjatë vitit, rezultatet e trajtimit të këtyre rasteve, kohën mesatare të nevojitur për përpunimin e tyre, si dhe masat konkrete të ndërmarra për të siguruar mbrojtjen e sinjalizuesve nga veprime hakmarrëse.

Ky raport jo vetëm që kontribuon në transparencën institucionale, por shërben edhe si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit. Ai i mundëson publikut dhe aktorëve institucionalë të kenë një pasqyrë të qartë mbi funksionimin e sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjen efektive të sinjalizuesve. Gjithashtu ILDKPKI publikon periodikisht të dhëna të përmbledhura mbi ecurinë e sinjalizimeve dhe masat mbrojtëse të ndërmarra, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27, parashikon kundërvajtjet dhe masat administrative. Ky nen përcakton qartë masat administrative që zbatohen në rast të shkeljeve të dispozitave të ligjit për sinjalizimin, kur këto shkelje nuk përbëjnë vepër penale. Këto shkelje trajtohen si kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjoba të përcaktuara sipas natyrës dhe rëndësisë së shkeljes.

Në mënyrë të detajuar, neni parashikon penalitete për raste si: mosçaktimi i njësisë përgjegjëse nga institucionet apo subjektet private; pengimi ose kërcënimi ndaj sinjalizuesve; ndërmarrja e veprimeve hakmarrëse ndaj tyre; shkelja e konfidencialitetit; mosrespektimi i procedurave të hetimit administrativ; rastet kur vihen re përpjekje dhe kërcënime apo moszbatimin e urdhërit të ILDKPKI-së për të pezulluar ose ndërprerë veprimet hakmarrëse si dhe sinjalizimet e rreme të kryera me vetëdije.

Gjobat variojnë nga 100,000 deri në 500,000 lekë, në varësi të llojit të shkeljes. Këto masa synojnë të garantojnë funksionimin korrekt të sistemit të sinjalizimit dhe të mbrojnë sinjalizuesit nga çdo formë presioni apo hakmarrjeje.

Një ndër sanksionet e parashikuara në këtë dispozitë është edhe vendosja e gjobës në vlerën 500,000 lek, në rast të përsëritjes së shkeljes, për mos krijimin e njësisë përgjegjëse.

Autoriteti i përcaktuar për konstatimin e kundërvajtjeve dhe vendosjen e masave administrative është ILDKPKI, ndërsa ndaj vendimeve të tij mund të bëhet ankim sipas procedurave të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative. Të ardhurat që mbliidhen nga gjobat kalojnë në Buxhetin e Shtetit, duke reflektuar funksionin ndëshkues dhe edukues të këtyre masave.

Neni 28, parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore. Ky nen përcakton detyrimet institucionale për nxjerrjen e akteve nënligjore që garantojnë zbatimin efektiv të këtij ligji. Ky nen saktëson afatet dhe përgjegjësitë e tre kategorive kryesore: Këshillit të Ministrave, ILDKPKI-së dhe subjekteve private apo autoriteteve publike.

Neni 29 parashikon dispozitën tranzitore (kalimtare) në lidhje me hyrjen në fuqi të disa dispozitave të këtij projektligji, më konkretisht të nenit 3, pika 1 gërma a dhe ç; nenit 3, pika 2; nenit 3, pika 7; neni 7, pika 4; si dhe neni 14, pika 2, vetëm pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ky nen siguron një kornizë kohore të qartë për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe administrative që mundëson zbatimin e plotë dhe të unifikuar të ligjit.

Dhe në përfundim neni 30, i projektligjit parashikon shfuqizimin e ligjit aktual (para miratimit) të këtij projektligji, me hyrjen në fuqi të tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen ILDKPKI-ja, të gjitha autoritetet e tjera publike dhe subjektet private të cilat kanë më shumë se 50 punonjës, në përputhje me strukturën organizative të institucionit apo subjektit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 65, datë 28.05.2025, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

dhe i përbërë nga anëtarë të institucioneve: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në të njëjtën kohë në cilësinë e sekretariatit teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ka asistuar dhe pregatitur paketën e plotë të projektligjit, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues nga institucione në statusin e të ftuarit, si përkatësisht: ILDKPKI, KQZ, SPAK e Prokuroria e Përgjithshme. Hartimi i projektligjit u mbështet dhe u konsultua ngushtësisht nga ekspertët e fushës, përvoja e të cilëve ka qenë një vlerë e shtuar gjatë procesit të hartimit, si dhe nga asistenca teknike e projektit EU4GG, e cila ka dhënë një kontribut të drejtëpërdrejtë në hartimin dhe konsolidimin e Tabelës së Përputhshmërisë (ToC).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të projektligjit përsa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve janë vlerësuar duke u bazuar tek informacioni që është në dispozicion. Kështu, shpenzimet ekzistuese nuk mund të llogariten plotësisht pasi mungon informacioni në lidhje me kohën e punës që shpenzohet nga njësitë përgjegjëse për sinjalizim për të kryer këtë detyrë specifike, përsa kohë punonjësit e njësisë përgjegjëse janë persona të caktuar me këtë detyrë të shtuar, brenda institucionit ku ndodhen. Shpenzimet janë të lidhura me zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shpenzime korente të tjera. Për vitin 2026, shpenzimet e llogaritura (shtesë dhe ekzistuese) janë 18.2 milionë lekë, ndërkohë që për periudhën 2026-2028 shpenzimet janë 42.1 milionë lekë. Përsa i përket të ardhurave, duke u bazuar tek të dhenat historike, mund të parashikohet se për periudhën 2026-2028 të ardhurat do jenë minimalisht 4 milion lekë. Duke marrë parasysh kompleksitetin dhe ndjeshmërinë që shoqëron procedurën e sinjalizimit, është e domosdoshme që, përveç përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen e individëve që do të jenë pjesë e njësive përgjegjëse për sinjalizimin, të garantohet gjithashtu një nivel i lartë integriteti profesional për secilin prej tyre. Kjo mund të sjellë nevojën për rritje të kapaciteteve njerëzore në disa institucione publike. Paralelisht, këta individë duhet të ndjekin trajnimet e nevojshme, në mënyrë që të përmbushin në mënyrë efektive funksionin e ngarkuar.

Në përputhje me dispozitat e projektligjit, parashikohen ndërhyrje në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së sinjalizuesve. Ata do të përfshihen si një nga grupet vulnerabël që përfitojnë ndihmë juridike falas.

PROPOZUESI

**MINISTRI I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTIKORRUPSIONIN**

ADEA PIRDENI